- (b) Menaxheri i Projektit urdhëron shtyrje pa dhënë llogari për këtë, ose vonohet apo nuk i jep skicat (vizatimet, specifikacionet) apo udhëzimet e duhura për kryerjen e punëve të kontraktuara në afatit e caktuar si në kontratë.
- (c) Menaxheri i Projektit urdhëron kontraktuesin që t'i zbulojë ose kryejë testet në punën përfundimtare, e cila mandej zbulohet se nuk ka pasur defekt
- (d) Kontraktuesit tjerë, autoritetet publike, shërbimet komunale ose Autoriteti Kontraktues shkaktojnë vonesë apo shpenzime shtesë për Kontraktuesin.
- (e) Parapagimi vonohet.
- (f) Menaxheri i Projektit pa arsye të justifikuar vonohet në lëshimin e vërtetimit për përmbushje të kontratës.
- (g) Kontraktuesi has në pengesë për kryerjen e aktiviteteve të punëve të kontraktuara të cilat pengesa nuk janë për shkak të joprofesionalizmit të Kontraktuesit.

30.2 Nëse një ngjarje e tillë ndodh, atëherë Çmimi i Kontratës do të rregullohet po ashtu.

### **PRANIMI DHE PËRGJEGJËSIA MBI DEFJEKTET**

#### **Neni 31 Parimet e përgjithshme**

31.1 Verifikimi i punëve nga Autoriteti Kontraktues me qëllim të pranimit të përkohshëm ose final do të bëhet në prani të Kontraktuesit. Mungesa e kontraktuesit nuk do të jetë pengesë për verifikimin me kusht që Kontraktuesi të jete informuar prej të paktën 30 ditëve para datës së verifikimit.

#### **Neni 32 Testet për përfundimin**

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

### **Neni 33 Pranimi i përkohshëm**

33.1 Punimet do të merren përsiper nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengese dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjëndjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

### **Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet**

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshëm i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të filloj nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdohet vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjoj një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i

projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

### **Neni 35 Pranimi përfundimtar**

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke çekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jete nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

### **SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA**

#### **Neni 36 Shkelja e kontratës**

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontrates.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

#### **Neni 37 Shkëputja e kontratës**

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shumën minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

### **Neni 38 Forca madhore**

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

### **Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës**

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shumat totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

### **Neni 40 Prona**

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

### **Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi**

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri I Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

## **ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

### **Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve**

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të

arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

**Neni 43      Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore**

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

## KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 617-23-5809-5-2-1/C569

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës për periudhën deri më 31.08.2024 pastaj do të nënshkruhet kontrata .
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve</li> <li>2. humbje ose dëmtim i Pajisjeve</li> <li>3. humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve)</li> <li>4. dëmtim personal ose vdekje:                             <ol style="list-style-type: none"> <li>(i) të punëtorëve të Kontraktuesit</li> <li>(ii) të personave të tjerë</li> </ol> </li> </ol> <p><b>Përgjegjësi mbanë kontraktuesi (OE)</b></p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda tri ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
Fillimi i punëve	17.1	<b>Data e fillimit do të jetë: 21.07.2023</b>
	17.2	<b>Data e përfundimit e të gjitha punëve do të jetë 31.07.2024</b>
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	OE është i obliguar të mbaj regjister të punës, dhe dokumentacionin

		tjetër që është parapar me ligj
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit emrohet nga ZKA
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: N/A
Mënyra e Paguesave	30.1	<p><b>Pagesa do të bëhet si në vijim:</b></p> <p>Pagesa në shumë prej 40,000.00 euro do të bëhet nga buxheti i vitit 2023 në bazë të situatave (Çertifikatave) të verifikuara nga Menaxheri i kontratës. Ndërsa shuma prej 45,733.54 euro, do të bëhet nga buxheti i vitit 2024</p> <p>Pagesat OE,do t'i bëhen sipas situatave të punëve të përfunduara (Çertifikatave) të aprovuara nga menaxheri i kontratës.</p> <p>OE, duhet të sjellë këto dokumente për pagesën e fundit :</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1.Garancioni për punët e kryera për( 12 muaj )</li> <li>2.Raporti i pranimit teknik nga komisioni</li> <li>3.Situacioni përfundimtar .</li> <li>4.Fatura e rregullt.</li> <li>5.Raporti nga mbikqyrësi për përfundimin e punëve me plan dinamik</li> </ol>
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	OE,është i obliguar të sjellë një garancion bankar ose nga kompania e sigurimit të vlerës së 10% të kontratës për periudhen 12 mujore nga data e pranimit teknik të projektit.
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve .AK do të bëjë pagesën e punëve të përfunduara , të vërtetuara nga menaxheri i kontratës:
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	<i>Palet kontraktuese do të bëjnë përpjekje për t'i zgjidhur mosmarrveshjet eventuale , përmes mirëbesimit ose negociatave miqësore .</i>
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet lënda në gjykatën Kompetente .

**PROJEKTI :ASFALTIMI RRUGËVE DHE RREGULLIMI I NDRICIMIT PUBLIK DHE TROTUARIT NË SHITIME, RR."12QERSHORI, RR."14DHJETORI", SEG. I-RR."TAHIR SINANI", SEG I RR."ADEM JASHARI", RENOVIMI I SHESHIT "AHMET SHTIMJA" DHE TROTUARIT NË RR."AHMET SHTIMJA"**

TRATUARI NE RRUGEN AHMET SHTIMJA B=1.5m L=1015.27m					
Nr.	PUNIME PARAPREGADITORE	Njësia	Sasia	Çmimi	Gjithësej (€)
1.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë si dhe largimi i instalimeve ne punishta në rast se ka në ato hapësira.	m <sup>2</sup>	1,015.27	0.50	507.64
1.2	Shenimi i trasesë si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit.	m <sup>2</sup>	1,015.27	0.50	507.64
1.3	Pastrimi i trases se rruges nga te gjitha materialet qe pengojnë pregaditjen e plenumit.Ne qmim te kalkuloohen te gjitha materialet e panevojsheme komplet per gjatesi te rruges.	m <sup>2</sup>	1,015.27	0.50	507.64
<b>Gjithsej 1.0:</b>					<b>1,522.91</b>
<b>2.0</b>	<b>PUNIMET E DHEUT</b>				
2.1	Germimi i tamponit t=10 cm me mundesi qe i njejti prap te perdoret.	m <sup>3</sup>	167.52	0.10	16.75
2.2	Germimi i dheut me makeneri i kategorisë së IV-V të me ngarkim dhe bartje deri në depëni (derini në 15Km). Sasia të llogaritet në gjendje natyrale.	m <sup>3</sup>	1,005.12	0.15	150.77
2.3	Fornësimi dhe ngjeshja e nenbazes se trupit te rruges me ngjeshësi 40MN/m2.	m <sup>2</sup>	1,675.20	2.50	4,187.99
<b>Gjithsej 2.0:</b>					<b>4,355.51</b>
<b>3.0</b>	<b>MBISTRUKTURA</b>				
3.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (80MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=25cm, si dhe ngjeshja me cilindër 25t.	m <sup>3</sup>	450.00	3.00	1,350.00
3.2	Furnizimi,transporti dhe punimi i tamponit (100MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=15cm, si dhe ngjeshja me cilindër 25t.	m <sup>3</sup>	250.00	4.00	1,000.00
3.3	Furnizimi , transporti dhe vendosja e skajoreve ne bazament betoni , C-35/37. Verejtje : Ne qmim kalkulohet edhe furnizimi me beton , perforcimi i bazamentit dhe fugave te skajorit me te gjitha punet teknike per realizimin e ketij pozicioni llogaritet ne m'.				
	me dim.10x20x100cm	m'	1,015.27	5.00	5,076.35
	me dim.15x24x100cm	m'	1,015.27	8.00	8,122.16
3.4	Sigurimi , me pahi mbrojtëse ,punimi dhe perforcimi i skajorit duke i krijuar shputë beton arme ku ndërtohet trotuari përreth kanalit atmosferik të hapurës , me qëllim që mos shembet .Punimet kryhen sipas gjendjes ekzistuese ne teren duke i rrespektuar , normat dhe standardet .Llog në komplet gjatësin e trotuarit	komplet	1.00	5.00	5.00
3.5	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e kubzave te betoni t=8cm, C-35/37 në shtres rërë frak. (4-8)mm me t=5cm dhe mbushja e fugave me rër, duke përfshir edhe zgjerimet dhe kyqjet ne rrugë.	m <sup>2</sup>	1,015.27	9.00	9,137.43
3.6	Ngritja dhe nivelizimi i pusetave të kanalizimit ekzistues deri ne nivelin e kubzave, si dhe furnizimi me kapk metalik 25t dhe montimi i tyre në bazament betoni. Copë	copë	20.00	8.00	160.00
3.7	Rregullimi i trases dhe pastrimi i punishtes nga materialet ndertimore.	m <sup>2</sup>	1,015.27	1.00	1,015.27
3.8	Furnizimi , transporti dhe vendosja e lëshesave (tombnave) rrethore prej gypave të parapregaditura nga betoni DN 315 te kanali atmosferik ku vendoset trotuari, Kokat hyrëse dhe dalje të lëshesave te pregaditen dhe punohen nga betoni i armuet C25/30 —sipas Detajeve të skicuara në projekt me kallopët prej drrasave .Llogaritur në m'.	m <sup>2</sup>	976.50	1.00	976.50
<b>Gjithsej 3.0:</b>					<b>26,842.71</b>
<b>I. REKAPITULLIMI I NDRITIMIT TROTUARVE</b>					
<b>1.0</b>	<b>PUNËT PARAPRAKË</b>			<b>Gjithsej 1.0:</b>	<b>1,522.91</b>
<b>2.0</b>	<b>PUNIMET E DHEUT</b>			<b>Gjithsej 2.0:</b>	<b>4,355.51</b>
<b>3.0</b>	<b>MBISTRUKTURA</b>			<b>Gjithsej 3.0:</b>	<b>26,842.71</b>

TOTALI ME TVSH: 32,721.12

2 NDRICIMI PUBLIK I RRUGES ILMI KAMERI - SHTIME					
Nr.	PUNIME PARAPREGADITORE	Njesia	Sasia	Çmimi	Gjithësej (€)
Nr.	Pershkrimi i puneve dhe materialeve	nj.matese	sasia	cmimi	shuma
A	Punët përgaditore				
1	Mobilizimi i nderremarrjes per fillimin e punimeve ne projekt.Në çmim te llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes se makinave dhe stafit punues	m <sup>1</sup>	204.66	0.50	102.33
<b>Gjithësejt:</b>					<b>102.33</b>
Pos2	Punët e Ndricimit				
2.1	Furnizimi dhe shtrirja e kabllit gërshetë NYY/ 4X16mm <sup>2</sup> (PP00) toksore	m <sup>1</sup>	204.66	2.50	511.65
2.2	Furnizimi dhe montimi i shtrengueseve (Ajrorgë shtylla metalike) 4x16 mm <sup>2</sup>	copë	5.00	3.00	15.00
2.3	Furnizimi dhe montimi i klemave Al Cu per lidhjen e dritvae	copë	5.00	3.00	15.00
2.4	Furnizimi, montimi i rrahevo(unazavo) për shtyllë	copë	5.00	10.00	50.00
2.5	Furnizimi me kabell 2X1.5mm <sup>2</sup> për lidhjen e drites	m <sup>1</sup>	60.00	2.00	120.00
2.6	Hapja e kanalit, furnizimi me kabell NYY/4X25mm <sup>2</sup> (PP00) per furnizim te ormanit me gjatesi mesatare 15m, betonimi i bazamentit të ormanit dhe mbyllja e kanalit duke parapare dhe pastrimin e teronit	komplet	1.00	10.00	10.00
2.7	Porosia dhe montimi i Kuadrit qendror për furnizimin e ndricimit publik, me pjesën e gjamit shtesë nga jashtë për leximin e njehësorit, pjesën e zbrazur rezerve të mbrojtur e Dekarpiruar me dim (120.x90x30). -Njehësorë elektrikë 3x230/400V 1 -Ndërprerës AS-/A 1 -Transformatorë rrymorë /5 A 6 -Mikrondërprerë /A 1 -Portilampë E27 1 -Poç fluoshent 1x18w me baze 1 -Prizë OG 16 A 1 -Voltmetër Vm 0-500 V 1 -Ampermetër Am 0-200A 1 -Ndërp. Zgjedhës për Am80A-u-R10 1 -Ndërprerës tipi GS-16-66 U 1 -Sig. Tripolare automatike /A te vendosura ne kuti per 3 siguresa komplete 3 ORS siguresa 9 patron /A -Siguresa njëpölare automatike 10-16A 6 copë schneider -Përçues 1x25 mm 2 (m) 50 -Kontëktorë tip CS 160 ose 100A 3 -Ndërprerësi automatik/A 1 -Rele IC Astrq 1 Komplet me shtrëngues dhe material tjetër si dhe skema njëpölëshe e vendosur brenda dhe numri i ormanit i vendosur jasht si dhe shenja e rrezikut , si dhe bazamenti nga betoni per vendosjen e kuadrit	copë	1.00	80.00	80.00

	<p>Llamba 40W e LED teknologjisë e prodhimit evropian, nga aspekti i dizajnit dhe kualitetit duhet ti plotësoj standardet Evropiane. Po ashtu këto llamba LED të kenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Llamba të ketë bazë qeramike apo ekuivalent për ftohje efikase; me ajrosje natyrale</li> <li>Të ketë logo të gravuar të prodhuesit në shtëpizë të llambës apo ekuivalente</li> <li>Mbërthyes të cilët nuk koorodoohen</li> <li>Mbrojtje mekanike; IP67</li> <li>Qëndrueshmëri: ≥ 50 000 (h/pune); me L70 / B20</li> <li>Efikaçiteti i ndriçueshmërisë së LED-it: ≥ 140 lm/W</li> <li>Temperaturë të ngjyrës: ≤ 4000 K</li> <li>Tension pune: 90...260 V (50Hz)</li> <li>Faktor të fuqisë (PF): ≥ 0.95</li> <li>CRI: ≥ 70</li> <li>Temperaturë pune: (-40 ...+55)°C</li> <li>Ftohja: me rrymim natyral të ajrit</li> <li>Mundësi për montim horizontal dhe vertikal dhe me kënd të rrotullimit prej +/- 25°</li> <li>Të posedoi mburojtje nga mbiteusioni (rrufeja) prej 10 kA.</li> <li>Mbrojtje në goditje: ≥ IK10</li> <li>Garanci: ≥ 5 vite</li> </ul>				
2.8		copë	5.00	100.00	500.00
2.9	Furnizimi dhe montimi i lirave Ø 60mm me gjatesi 1,5m te lakuar sipas kërkeses se organit mbikqyres, te zinkuara	copë	5.00	10.00	50.00
2.10.	Furnizimi dhe vendosja e shtyllave metalike të ndriçimit me lartësi H= 9m, me derë për hapje dhe trashësi të mureve konform standardeve për zonë të II-të të erës. Shtyllat e NP të jenë nga materiali ST 37 (S235 JR), të galvanizuara sipas standardit; EN ISO 1461, konike, njëtrajtësisht të punuara (pa saldime të pjesëve). Sk. 1. Vërejtje në qmim kalkulohet hapja e grëpës me të gjitha punë përcjellëse të paraparë zhavorrike , si dhe betonimi i bazamentit për vendosjen e shtyllës duke përfshirë edhe ankerët e nevojshme , punët të kryhen në pajtim me kushtet teknike standardet dhe normativat ndërtimore.	copë	5.00	300.00	1,500.00
3	Atestet e te gjitha materialeve te perdorura	komplet	1.00	100.00	100.00
3.1	Materiali i imet i paraparë	komplet	1.00	10.00	10.00
				<b>Gjithsejt:</b>	<b>2,963.65</b>

## 2. REKAPITULLIMI I NDRIÇIMIT

1.0	PUNËT PREGADITORE	Gjithsej 1.0:	102.33
2.0	PUNËT PREGADITORE	Gjithsej 2.0:	2,961.65
		<b>TOTALI ME TVSH:</b>	<b>3,063.98</b>

3. ASFALTIMI I RRUGES I RRUGES SEGMENTI ADEMI JASHARI					
3. ASFALTIMI I RRUGES L=112m ; B=3m					
	Përshkrimi i pozicioneve	Njesia	Sasia	Cmimi njesi (€)	Cmimi total me TVSH (€)
Te gjitha punet ne perputhje me normat teknike dhe standardet Evropiane dhe Eurokodit , Kompania pune kryese eshte pergjegjese per ti marre masat mbrojtese dhe te siguroj punishten me mjete sigjalizuese para fillimit te punet, ne gjithë zonën ku do te zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare					
PUNËT PREGADITORE					
1.1	Shënjimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detal , gjatë kohës sa zgjatim punimet .Llog në m2	m2	336.00	1.50	504.00
1.2	Identifikimi dhe dislokimi i instalimeve nëntoksor dhe mbitoksorë (tjersjellës, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), pikerimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qellim të evitimin parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qellim që të hartohet plani i veprimt për shlyqje dhe dëmolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terrenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe Asfaltimin në rrugat lokale të Qytetit. Llog m2	m2	336.00	1.50	504.00

1.3	Shënimi dhe inçizimi gjeodezike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detaj gjatë kohës së zgjatit punimet. Llog në m <sup>2</sup>	m2	336.00	1,50	504.00
Gjithsej: Pos 1					1,512.00

<b>PUNIMET TOKËSORE</b>					
Gërryerja, gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndërtime në vendet e projektit për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashësi t = 20 deri në 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terrenit me ramjet e duhura duke përfshirë edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuara në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dheut të germuar në deponin të cilën e cakton investitori Llog m3 me të gjitha shpenzimet.					
2.1	Gërmimi me makineri (70%)	m3	103.49	0.20	20.70
2.2	Gërmimi me dorë (20%)	m3	29.57	0.20	5.91
2.3	Gërmimi me çekan (10%)	m3	14.78	0.20	2.96
2.4	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rrugës , para se të vendosen shtresat e tamponit Llog me të gjitha shpenzimet	m2	336.00	2,50	840.00
Gjithsej: Pos 2					869.57

<b>PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)</b>					
3.1	Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës stabilizuese me material mbushës nga guri gëlqeror që plotëson kushtet dhe kriteret e parapara për tampon Fraksion 0-150 mm për stabilizim të pjesëve anësore dhe plotësim të trasës së rrugës. Ngjeshet në shiresa me trashësi të shtresës t=30 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=250 kg/cm2. Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëdhënëse është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.	m3	184.80	0.70	129.36
Furnizimi dhe punimi i bazamentit me gurë gëlqeror Fraksion 0-150 mm Llog në m3					

Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 63 ) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=650 kg/cm2. Materiali i përdorur duhet të jetë i paësuar me ateste paraprake dhe atë sipas normave dhe standardeve. Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëdhënëse është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
---	--	--	--	--	--

3.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm, t=20cm	m3	123.20	5.00	616.00
-----	---	----	--------	------	--------

Furnizimi, transporti, shtrirja, nivelizimi i bazës dhe punimi i bazës së rrugës , me materialin guror nga gurit të thyer fraksion (0-32) mm, me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues. Materiali i përdorur duhet të jetë i paësuar me ateste paraprake dhe atë sipas normave dhe standardeve. Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2. Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëdhënëse është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
--	--	--	--	--	--

3.3	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31,5 mm, t= 10 cm	m3	61.60	5.00	308.00
-----	---	----	-------	------	--------

Gjithsej: Pos 3					1,053.36
-----------------	--	--	--	--	----------

<b>PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ASFALTE</b>					
4.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i asfalt betonit nga materiali i njëtrajtshëm AB 0-16mm me trashësi t=7,0cm si dhe sterpikjen me emulsion 0.1-0.2 kg/m2 në tërë hapësirën e rrugës para shtrimit të asfalt betonit. Llog në m2 Vrejtje : Të mirë në mostrat në vend dhe të bëhet ATESTI -METODA MARSHALL	m2	961.00	5,00	4,805.00
4.2	Furnizimi dhe montimi i skajoreve nga betoni C-30/37 dim. (15x25x80) cm, me baza betoni llogaritur me të gjitha punimet e tjera të nevojshme. Vrejtje : Në qmën kalkulohet edhe furnizimi me beton , perforcimi i bazamentit dhe fugave të skajorit me të gjitha punet teknike për realizimin e kësaj pozicioni llogarit në m <sup>3</sup> .	m <sup>3</sup>	224.00	2,00	448.00
4.3	Furnizimi, transporti, punimi dhe nivelizimi i kokave të pusëve me shtresën finale të Asfaltit, koka përforcohen me beton armë , inkastronhet unaza metalike, si dhe vendosja e kapakut nga giza 60T i qëndrueshëm ndaj komunikacioneve të rënda. Qmimi kalkulohet në m <sup>2</sup> të rrugëve të kubëzuara. Vrejtje : Ky pozicion aplikohet kur paraqitet nevoja e ngritjes së pusëve ekzistuese në rrugë për implementim të projektit , për shkak se pusetat po janë mbuluar me zhavorr apo asfalt.	copë	4.00	10,00	40.00
Gjithsej: Pos 4					5,293.00

<b>1. REKAPITULIMI - ASFALTIMI RRUGËS SEGMENTI ADEM JASHARI</b>					
---	--	--	--	--	--

1	PUNËT PREGADITORE			Gjithsej: Pos 1	1,512.00
2	PUNIMET TOKËSORE			Gjithsej: Pos 2	869.57
3	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)			Gjithsej: Pos 3	1,053.36
4	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ASFALTE			Gjithsej: Pos 4	5,293.00
<b>TOTALI ME TVSH</b>					<b>8,727.93</b>

<b>4. KUBËZIMI I RRUGËS TAHIR SINANI</b>					
4. KUBËZIMI I RRUGËS L=36m ; B=3m					
	Përshkrimi i pozicioneve	Njesia	Sasia	Cmimi njësi (€)	Cmimi total me TVSH (€)

Të gjitha punët në përputhje me normal teknike dhe standarde evropiane dhe Eurokodit, Kompania punë kryese është përgjegjëse për të marrë masat mbrojtëse dhe të sigurojë punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punëve në zonën ku do të zhvillojë aktivitetet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntokësore të qytetarëve është e obliguar li kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare

PUNËT PREGADITORE					
1					
1.1	Shënimi i kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet të infrastrukturë rrugore sipas projektit detaj gjatë kohës së zgjatit punimet Llog në m2	m2	108,00	2,00	216,00
1.2	Identifikimi dhe dislokimi i instalimeve nëntokësore dhe mbrojtëse (tufesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonike dhe internetit), pikellimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në lëvizimin e personelit. Në këtë pozicion përfshihet edhe plani i situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimt për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pasirimin e terrenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubëzave në rrugët lokale të Qytetit. Llog m2	m2	108,00	2,00	216,00
